

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Kaçaniku – Raporti komunal

Nëntor 2009

Kaçaniku në shifra

Popullsia	Gjithsej	59755
	Shqiptarë	99.9%
	Të tjerë	0.1%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	306
	Numri i fshatrave	31
Shkollimi	Pa shkollë/ fillore e papërfunduar	12.7%
	Fillore/ e mesme e papërfunduar	40.76%
	E mesme	40.33%
	Shkollë e lartë	5.61%
	Universitet	0.59%
	Nr. i nxënësve	8757
	Nr. i mësimdhënësve	559
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	2
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	28
	Nr. i çerdheve	1
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	9
	Nr. i mjekëve	20
Papunësia	Gjithsej	45.28%
	Meshkuj	40.75%
	Femra	65.38%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	36,451
	Të punësuar në sektorin publik komunal	772
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	3,640,359
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	258,250
	Të hyrat tjera (Euro)	3,382,109
Shpenzimet e realizuara (2008) ¹	Gjithsej (Euro)	3,171,820 (91%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	378,164 (64%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	2,793,656 (97%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	51.58%
	LDK	17.09%
	AKR	10.31%
	AAK	10.01%
	LDD	6.27%
	ORA	3.23%
	Tjera	1.51%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Tahir Çaka (PDK) 2002-2007: Xhelal Gashi (PDK) 2007-2009: Xhabir Zharku (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Kaçanikun

Komuna e Kaçanikut ka një sipërfaqe prej 306 km² dhe përbën 2.8% të sipërfaqes së Republikës së Kosovës. Kjo komunë ka rreth 59,000 banorë dhe shtrihet në jug të Kosovës. Kaçaniku ka hyrë në librat e historisë së popullit shqiptar si vend ku janë zhvilluar beteja të lavdishme të luftës për liri, në Grykën e Kaçanikut, dhe vend ku më 1990 në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila gjerësisht filloi të njihej si Kushtetuta e Kaçanikut. Po në territorin e kësaj komune ndodhet edhe maja më e lartë në Kosovë – “Maja e Lubotenit”. Lumenjtë Lepenci dhe Nerodimja kalojnë nëpër Kaçanik. Të gjitha këto karakteristika gjeografike, e bëjnë këtë komunë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit dhe me një klimë të përshtatshme për shërim të sëmundjes së turbekulozit. Që nga viti 2005, Komuna e Kaçanikut është zvogëluar për nga numri i territorit dhe popullsisë, ngase 11 lokalitete (83 km/2) dhe 10,000 banorë tani bëjnë pjesë në komunën e re të Hanit të Elezit.

Problemet aktuale

Edhe përkundër pasurisë nëntokësore që ka kjo komunë si dhe kapaciteteve të mëdha për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit, prapë se prapë shkalla e papunësisë në këtë komunë mbetet problem serioz që po reflektohet edhe me largimin e popullatës. Ambienti jo i pastër dhe rinia e lënë anash, përbëjnë gjithashtu disa nga problemet më aktuale që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme nga organet kompetente komunale. Ndër problemet tjera me të cilat ballafaqohet kjo komunë janë:

- Papunësia dhe moszhvillimi ekonomik
- Papastërtia e ambientit
- Shëndetësia
- Dukuritë negative në mesin e rinisë

Me gjithë potencialin e madh për zhvillim ekonomik, **papunësia** në Komunën e Kaçanikut mbetet ende e lartë. Kjo komunë në mes tjerash është e pasur edhe me pasuri nëntokësore, është vendkalim për pikën kufitare me Maqedoninë, ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, e sidomos atë të pemëtarisë dhe blegtorisë, si dhe është e përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor. Megjithatë, kjo komunë përballet me një papunësi të lartë, sidomos tek të rinjtë kaçanikas, të cilët si zgjidhje të vetme shohin migrimin. Rreth 45.2% e popullsisë së aftë për punë nuk mund të gjejnë një vend pune. Në Qendrën Komunale të Punësimit janë të regjistruar 8,027 punëkërkues apo 13.4% e popullsisë së përgjithshme. Por numri i të regjistruarve si të papunë, nuk paraqet pasqyrën reale të papunësisë, ngase shumë punëkërkues nuk regjistrohen në Qendrën e Punësimit. 681 familje me 3,194 anëtarë jetojnë me ndihma sociale (5.3% e popullsisë).

Komuna e Kaçanikut si problem madhor ka edhe **papastërtinë e qytetit**, e njëherazi edhe keqpërdorimet që i bëhen natyrës (sidomos pyjeve). Kompania shoqërore e pastrimit “Pastërtia” e Ferizajt, është përgjegjëse për pastrimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, por të cilët nuk janë edhe aq efikas në këtë komunë. Për më shumë ata mbledhin mbeturinat vetëm në zonat ku bëhet pagesa (e që janë të pakta në këtë komunë), dhe si rezultat i tillë Komuna e Kaçanikut pothuajse është vërshuar nga mbeturinat e hedhura kudo. Qytetarët akuzojnë komunën e cila nuk ndërmerr hapa në këtë drejtim, qoftë përmes presionit që duhet bërë tek qytetarët të cilët nuk

paguajnë kompaninë për mbledhjen e mbeturinave, qoftë përmes ndëshkimeve nga inspektorët e komunës për qytetarët që hedhin mbeturinat kudo, apo edhe përmes presionit që i duhet bërë kompanisë së mbeturinave "Pastrimi". Ajo çfarë ka bërë komuna në këtë drejtim është përpilimi i programit "Ndihma komunale për skemat sociale" nëpërmjet së cilës komuna ka paguar një shtesë prej 100 eurove disa qytetarëve që gjatë 3 muajve të verës kanë bërë pastrimin e lumenjve, varrezave dhe disa pjesëve kyçe të qytetit nga mbeturinat e tepërta. Megjithatë, qytetarët e vlerësojnë këtë vetëm si zgjidhje të përkohshme dhe jo zgjidhje konkrete të një problemi kaq evident, që mund të ndikoj edhe në përhapjen e sëmundjeve të ndryshme epidemike. Një tjetër shqetësim është edhe keqpërdorimi i pyjeve apo prerja e pakontrolluar e tyre.

Shëndetësia paraqet një tjetër problem në Komunën e Kaçanikut. Kjo komunë nuk ka asnjë spital, edhe pse në të kaluarën ka pas një të tillë. Ka një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe 2 qendra të tjera me 7 punkte gjithsej. Sa i përket numrit të mjekëve, 20 të punësuar janë gjithsej, nga këta 2 janë stomatolog, ndërsa të tjerët janë mjek të përgjithshëm. Mjekësia familjare ka edhe 2 bashkëpunëtor të jashtëm, neuropsikiatrin dhe pulmologun. Edhe pse Komuna e Kaçanikut ka klimë shumë të përshtatshme për shërimin e tuberkulozit, ende nuk është investuar asgjë në drejtim të ndërtimit të një spitali për këtë qëllim. Qytetarët e kësaj komune ankohen se ka mungesë dhe orar të rregullt të mjekëve në punkte shëndetësore në pjesët rurale dhe si zgjidhje e vetme atyre u mbetet që të vizitojnë QKMF-në në qytet.

Mungesa e punës, arsimit dhe aktiviteteve rinore kanë rezultuar me paraqitjen e shumë **dukurive negative në mesin e rinisë**. Komuna nuk ka asnjë strategji apo angazhim për të fuqizuar rolin e rinisë dhe për ta kyçur atë në jetën publike, edukimin e saj më të mirë dhe sidomos punësimin. Si pasojë e mungesës së kushteve për shkollim cilësor dhe vende të punës për të rinj, ka rezultuar që shumë të rinj të largohen për në qytetet e tjera të Kosovës, por më shumë vërehen përpjekjet që rinia të largohet për jashtë vendit për një jetë më të mirë. Bashkëbiseduesit shprehen të brengosur se numri i përdoruesve të lëndëve narkotike dhe alkoolike është duke u shtuar dukshëm. Mospërkrahja e aktiviteteve kulturore për rininë, siç janë klubet e ndryshme sportive, grupet muzikore etj., dhe krejt ky pasivitet i rinisë është faktor kyç që ndikon në rritjet e migrimin. Edhe femrat janë të nën përfaqësuar në çdo aspekt. Edhe pse shumë është punuar në emancipimin dhe fuqizimin e femrës në Komunën e Kaçanikut, angazhimi i femrave në jetën publike komunale ende mbetet problem shqetësues. Në administratën komunale të Kaçanikut, nga 113 punëtorë gjatë 2008, vetëm 20 prej tyre ishin femra. Në shëndetësi nga 105 punonjës, 70 janë femra; kurse në arsim nga 549 punonjës, 147 janë femra. Në nivel të përgjithshëm, përfaqësimi i femrës arrin në 30.9%. Kurse në pozita vendimmarrëse në shërbimin civil komunal, femrat nuk mbajnë asnjë pozitë vendimmarrëse.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Kaçaniku është njëra ndër katër komunat e Kosovës e cila në tri mandate është qeverisur nga PDK. PDK në Kaçanik ka udhëhequr me komunën për nëntë vite, me tre kryetar të ndryshëm. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) kryetar i komunës ishte Tahir Çaka (PDK). Në mandatin e dytë (2002-2007), me komunën udhëhoqi Xhelal Gashi, kurse në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, PDK konkurroi për postin e kryetarit të komunës me Xhabir Zharkun. Zharku në raundin e parë të zgjedhjeve

fitoi 7,147 vota apo 41.9%, duke shkuar kështu në balotazh ku për kundërshtar kishte Habib Shehun nga LDK. Në raundin e dytë Xhabir Zharku fitoi 75.3% të votave duke ia siguruar kështu partisë së tij edhe një qeverisje dy vjeçare.

Pretimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore janë realizuar pjesërisht. Padyshim premtimi më madhor ishte shpallja e zonave industriale me qëllim të joshjes së investitorëve të huaj. Ky projekt është realizuar; si zona industriale u caktuan dy fshatrat Doganaj dhe Bregoc, por, qytetarët edhe më tutje nuk shohin ndonjë përfitim nga ky projekt, pasi se ende nuk ka ndonjë plan konkret se si këto zona do të sjellin zhvillim ekonomik dhe ulje të papunësisë. Projekt tjetër i realizuar është krijimi i një zyre të veçantë për shërbime ndaj bashkatdhetarëve, zyrë kjo e cila funksionon vetëm gjatë verës. Nuk ka pasur investime në fshatin Kurbali, ku mes tjerash ka qenë e paraparë ndërtimi i rrugës së fshatit. Por, përveç disa investimeve të vogla nuk mund të thuhet se gjendja e rëndë e këtij fshati është përmirësuar. Ky fshat ka shumë pak shtëpi dhe ka lidhje më të mira rrugore me Vitinë se sa Kaçanikut. Nuk është bërë asgjë domethënëse as në drejtim të promovimit të turizmit malor.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Përmbushja e premtimeve
Shpalljen e zonave industriale dhe ato komerciale si bazë për të nxitur investimet në këtë komunë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të zbutet papunësia.	Sa i përket përcaktimit të zonave industriale/komerciale ato janë caktuar në 2 fshatra: Doganaj dhe Bregoc. Ende nuk ka ndonjë planifikim konkret se si do të stimulohen investitorët të investojnë në këto zona industriale.
Hapja e një zyre të veçantë për bashkatdhetarët.	Zyra për bashkatdhetarët është formuar dhe është aktive vetëm gjatë muajve të verës kur fluksi i bashkatdhetarëve është më i madh.
Rregullimi i rrugës në fshati Kurbali për t'iu mundësuar fshatarëve të kthehen në vatrën e tyre dhe të kenë një jetë më të mirë.	Projekti nuk është realizuar.
Investime dhe promovimi i turizmit malor.	Përpos realizimit të disa projekteve të vogla, siç është organizimi i festës së 2 gushtit ku mbledhen turistë nga vende të ndryshe të cilëve u krijohet një atmosferë festive, diç tjetër nuk është bërë. Madje, disa nga qytetarët ankohen se nuk i bëhet shumë promovim qoftë festës së 2 gushtit, qoftë beneficioneve të cilat i ofron Maja e Lubotenit, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e turizmit malor-veror.

Zgjedhjet lokale në Kaçanik

Komuna e Kaçanikut që nga zgjedhjet e vitit 2000 është qeverisur nga PDK. Në zgjedhjet e para të vitit 2000, partitë më të mëdha në këtë komunë dolën të jenë PDK dhe LDK. PDK në ato zgjedhje kishte marrë 9,302 vota apo 16 ulëse në KK, kurse LDK kishte marrë 7,069 vota apo 12 ulëse në KK, ndërsa partitë tjera me pjesëmarrje në KK dolën të jenë AAK dhe PRK. Kryetar i komunës ishte zgjedhur Tahir Çaka. Dy vite më vonë më 2002, PDK arriti t'i fitoj zgjedhjet përsëri megjithëse me një margjinë

shumë të ngushtë karshi LDK-së. Kësaj radhe PDK fitoi 8,643 vota karshi LDK-së e cila kishte fituar 7,910 vota. Nga 31 ulëse të KK, PDK-së i takuan 15, LDK-së 14 kurse 2 ulëse i takuan AAK. Edhe zgjedhjet e vitit 2007 nuk sollën ndonjë ndryshim në qeverisje. Partia më e madhe në këtë komunë PDK, përsëri kishte dominuar karshi partive tjera. PDK kësaj radhe fitoi 17 ulëse në KK kurse LDK vetëm 5. Për herë të parë në këtë garë ishin paraqitur edhe LDD dhe AKR, të cilat kishin fituar 2, gjegjësisht 3 ulëse në KK.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Kaçanikut.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	9302	16	8643	15	8537	17
LDK	7069	12	7910	14	2829	5
AAK	900	2	844	2	1657	3
PRK	318	1	-	-	-	-
LDD	-	-	-	-	1038	2
AKR	-	-	-	-	1706	3
ORA	-	-	-	-	535	1

Numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 75.1%, dy vjet më vonë ajo ra në 59.4%, kurse në vitin 2007 pjesëmarrja në votime ra në 51.8%. Sikurse në çdo komunë tjetër, edhe në komunën e Kaçanikut në tri palë zgjedhjet e kaluara numri i votuesve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, kurse pjesëmarrja e tyre në votime ka shkuar duke rënë. Në zgjedhjet e ardhshme të 15 Nëntorit 2009 të drejtë vote kanë 29,398 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Kaçanik në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	24905	30337	31912	29398
Pjesëmarrja në votime	18704	18031	16552	-
Përqindja e daljes në votime	75.1%	59.44%	51.8%	-

Buxheti i Komunës

Për dallim nga komunat tjera të cilat kanë pasur një ngritje të buxhetit prej vitit në vit, komuna e Kaçanikut që nga viti 2003 ka pasur pothuajse të njëjtin buxhet me pak luhataje. Përveç viteve 2007-2008 kur komuna kishte një buxhet rreth 2.8 milion euro, në përgjithësi kjo komunë ka pas buxhet prej mbi 3 milion euro. Nga tabela e më poshtme mund të vërejmë se buxhetin më të madh kjo komunë e ka në vitin 2009, me

gjithsej 3,640,359 euro. Krahasuar me vitin 2008 kur Kaçaniku kishte një buxhet prej 2,859,868 euro, buxheti i këtij viti është rritur për 780,491 euro.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	2,431,272	355,267	77,500	41,000	735,320	-	3,640,359
2008	1,997,439	394,741	84,342	41,000	342,346	-	2,859,868
2007	1,919,282	317,575	62,625	34,500	544,556	-	2,878,538
2006	2,232,514	438,864	69,400	50,700	745,266	-	3,536,744
2005	2,215,890	308,786	84,100	37,500	650,411	-	3,296,687
2004	2,168,176	605,710	-	-	620,821	43,533	3,438,240
2003	1,699,757	592,277	-	-	688,953	39,590	3,020,577

Nga tabela e më sipërme mund të shohim se ka pas një rritje të shpenzimeve edhe për rroga dhe mëditje. Në fakt pjesa më e madhe e buxhetit të vitit 2009 është shpenzuar për rroga dhe mëditje, gjithësej 2,431,272 euro. Kjo njëherit shënon edhe shpenzimin më të madh për rroga dhe mëditje që nga viti 2003.

Investimet kapitale

Nga buxheti i përgjithshëm, Komuna e Kaçanikut për vitin 2009 ka ndarë 735,320 euro për investime kapitale. Për dy vite (2008 dhe 2009), qeveria lokale ka ndarë rreth mbi 1 milion euro për investime kapitale. Në tabelën e më poshtme mund të shihni disa nga projektet e financuara nga ky buxhet.

Tab.5.: Investimet kapitale në Kaçanik gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës së fshatit Stagovë	€47,668
2008	Asfaltimi i rrugës Bobaj-Doganaj (faza e IV-të)	€34,800
2008	Asfaltimi i rrugës Dushkajë-Kaçanik	€29,410
2008	Asfaltimi i rrugës UÇK-Kaçanik	€16,550
2009	Asfaltimi i rrugës në fshatin Lumbardh	€164,569
2009	Asfaltimi i rrugës Bob (faza e II-të)	€60,000
2009	Asfaltimi i rrugës Topallë-Lirishtë	€83,000
2009	Asfaltimi i rrugës Lekaj-Doganaj	€60,000

Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Kaçaniku do të ketë në dispozicion 4,356,056 euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	4,331,658	4,477,008	4,629,547
Të hyrat vetanake në €	549,341	566,781	583,130
Investimet kapitale në €	1,308,160	1,446,073	1,601,823

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Kaçanikut për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion afër 6 milion euro për investime kapitale

Administrata komunale

Në komunën e Kaçanikut të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 772. Krahasuar me vitin 2008, numri i këtij stafi është zvogëluar për 7 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Kaçanikut duhet të ketë 108 punëtorë administrativ. Momentalisht, kjo komunë ka të punësuar 94 punonjës në administratën komunale, që do të thotë se komuna nuk ka staf të tepërt në administratë.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Kaçanikut sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	772
2008	779 ▲
2007	762
2006	926 ▲
2005	915
2004	960 ▲
2003	889 ■

Komuna e Kaçanikut dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK e Kaçanikut gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK e Kaçanikut ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 7 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2008 ka mbajtur tri, kurse për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 është mbajtur vetëm një tubim. Në dy vitet e fundit nuk është dorëzuar asnjë peticion nga ana e qytetarëve.

Komuna e Kaçanikut posedon edhe uebfaqen zyrtare të saj. Ueb faqes i mungojnë një sërë informacionesh ashtu që një qytetari do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të

komunës siç janë: shërbimet komunale, informacione rreth qytetit, si dhe legjislacioni komunal, etj.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut (www.komunakacanik.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	2.67
Shërbimet komunale	2
Info rreth qytetit	2
Projektet komunale	3
Lajme& lajmërim	1.67
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	3
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	2.61
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	18

Gjendja në arsim

Arsimi në Komunën e Kaçanikut zhvillohet në tri nivele, atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Ekziston vetëm një çerdhe për fëmijë që shërben edhe për nevojat e parashkollorëve. Janë gjithsej 28 shkolla fillore, apo thënë ndryshe 12 shkolla fillore me 16 paralele, ndërkaq numri i nxënësve në shkollën fillore është 6,262 nxënës. Kjo komunë ka edhe dy shkolla të mesme me gjithsej 1,690 nxënës. Numri i mësimdhënësve është 559. Përndryshe kjo komunë ka 0.9 punonjës arsimor për 100 banorë, duke e bërë Komunën e Kaçanikut me numrin më të vogël të punonjësve arsimor në Kosovë.

Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Kaçanikut ofrohet vetëm mjekësia primare. Kjo komunë ka QKMF, dy QMF të tjera dhe shtatë ambulanca në lokalitete të ndryshme. Numri i mjekëve është 20, kurse numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor është 110, apo 1.8 punëtorë shëndetësor për 1,000 banorë, duke e bërë Kaçanikun komunën me më së paku punonjës shëndetësor në Kosovë. Numri i mjekëve është i vogël, duke bërë që ambulancat shpesh të mbesin pa mjek, çfarë edhe i detyron qytetarët e viseve rurale të shkojnë deri në qytet. Kaçaniku veçohet për klimë të mirë e cila ndihmon në shërimin e tuberkulozit, por deri më tani nuk është bërë asgjë për ndërtimin e ndonjë spitali të specializuar për shërimin e kësaj sëmundjeje.

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Shoqëria civile

Nga organizatat e rralla aktive të shoqërisë civile në Kaçanik mund të përmenden “Handikos”, Organizatat e Veteranëve të Luftës dhe Kryqi i Kuq. Megjithatë, në këtë komunë mungojnë organizata të cilat do të merreshin me avokimin e çështjeve që i preokupojnë qytetarët, organizim të debateve, dhënie të rekomandimeve apo monitorim të punës së KK. Një organizatë e tillë që ka qenë aktive në këtë komunë, dhe tani ka mbetur me shumë pak staf, është OJQ “Zgjohu”. Në përgjithësi mungesa e infrastrukturës dhe hapësirës së nevojshme ka reduktuar numrin e aktiviteteve në këtë komunë dhe kështu edhe rolin e shoqërisë civile.

Mediat lokale

Media e vetme në Komunë është Radio Kaçaniku. Kjo radio ka kontratë për t’i transmetuar edhe mbledhjet e Asamblesë Komunale. Kjo radio edhe më tutje mbetet burim i vetëm i informacionit për qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Edhe gazetaret ditore kanë korrespondentët e tyre në këtë komunë, të cilët përveç ngjarjeve që ndodhin në komunën e Kaçanikut mbulojnë ngjarjet edhe nga komuna e Hanit të Elezit.

Rendi dhe ligji në Komunën e Kaçanikut

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Kaçanikut kanë ndodhur 848 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 52 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Kaçanik (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	72
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	91
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	12
Vjedhje e pyjeve	5
Incidente lidhur me pronën	38
Vjedhje	197
Abuzime seksuale	2
Shkaktim të dëmtimeve trupore	41
Kërcënime	23
Mashtrime	10
Vrasje	3
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	0

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifatat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje, edhe Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë me të cilën ka përcaktuar vlerën e pronës në treg, zonat komunale dhe normat tatimore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Kaçanikut

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.10%	0.20%	0.20%	0.05%
I	300 €	300 €	500 €	150 €	120 €
II	300 €	250 €	400 €	150 €	100 €
III	-	200 €	300 €	150 €	80 €
IV	-	150 €	250 €	150 €	80 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Kaçanikut janë të regjistruara 1,052 biznese private të llojeve të ndryshme. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Kaçanikut. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumatat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	300 €
Kompanitë e sigurimit	200 €
Barnatoret	300 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	200 €
Kompanitë transportuese	200 €
Agjensionet turistike	50 €
Hotelet	250 €
Motelet	200 €
Supermarketet - Hipermarketet	150 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	40 €
Kafeteritë	50 €
Restorant	150 €
Telekomunikimit	50 €
Gurëthyesit	200 €

Autoshkollat	100 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	20 - 60 €
Depot ndërtimore	100 €
Pompat e benzinës	300 €
Ndërmarrjet ndërtimore	100 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	50 - 100 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoha dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHIT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.